

VENDIM
Nr. 740, datë 12.12.2025

PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS DHE TË SKUADRËS KOMBËTARE TË ORGANIZIMIT PËR SAMITIN E NATO-s, TIRANË, 2027

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Task-Forcës – *Host Nation Task Force* (HNTF) dhe të Skuadrës Kombëtare të Organizimit për Samitin e NATO-s, Tiranë, 2027.

2. Task-Forca kryesohet nga Kryeministri dhe, në mungesë të tij, nga Koordinator i Kombëtar për organizimin e samitit, i emëruar me urdhër të Kryeministrit. Task-Forca ka në përbërje këta anëtarë:

- a) ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- b) ministrin e Mbrojtjes;
- c) ministrin e Shtetit për Pushtetin Vendor;
- ç) përfaqësuesin e kabinetit të Kryeministrit;
- d) sekretarët e përgjithshëm:
 - i. të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
 - ii. të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - iii. të Ministrisë së Financave;
 - iv. të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - v. të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
 - vi. të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
 - vii. të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit;
 - viii. të Ministrisë së Mbrojtjes;
- dh) shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- e) drejtorin e Shërbimit Informativ të Shtetit;
- ë) drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik;
- f) drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

3. Task-Forca mbështetet në veprimtarinë e saj nga një sekretariat teknik, që ngrihet pranë dhe nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Në mbledhjet e *HNTF*-së mund të ftohen, sipas nevojës, përfaqësues të institucioneve të tjera publike, si edhe ekspertë vendas ose të huaj, në varësi të çështjeve që diskutohen.

5. *Host Nation Task Force* është organ vendimmarrës për përcaktimin e detyrave dhe të përgjegjësiave institucionale në funksion të organizimit të Samitit dhe ka këta objektiva:

- a) të përcaktojë agjendën dhe programin politik e teknik të punës së Samitit;
- b) të shqyrtojë e të miratojë aktet, veprimet dhe kërkesat operacionale të propozuara nga Skuadra Kombëtare e Organizimit;
- c) të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave, nëpërmjet ministrit të Mbrojtjes, “Planin gjithëpërfshirës të veprimit për organizimin dhe mbarëvajtjen e Samitit të NATO-s, Tiranë, 2027”, duke përcaktuar:
 - i. hapat dhe masat e planifikimit;
 - ii. nevojat infrastrukturore, logjistike dhe institucionale;
 - iii. procedurat tekniko-juridike dhe instrumentet financiare;
 - iv. detyrat e detajuara për çdo strukturë;

ç) të vlerësojë kostot e organizimit e të propozojë, nëpërmjet ministrit përgjegjës për financat, buxhetimin përkatës në Këshillin e Ministrave;

d) të marrë masat për dislokimin e dispozitivit ushtarak dhe mbrojtës, në bashkërendim me strukturat ushtarake aleate.

6. Nën varësinë e *HNTF*-së ngrihet Skuadra Kombëtare e Organizimit (*National Organization Team – NOT*), e cila kryesohet dhe funksionon nën përgjegjësinë e Koordinatorit Kombëtar, si dhe përbëhet nga:

- a) drejtori i Protokollit të Shtetit;
- b) drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;
- c) drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit;
- ç) drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- d) komandanti i Gardës së Republikës;
- dh) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
- e) përfaqësuesi i Shërbimit Informativ të Shtetit;
- ë) përfaqësuesi i Kabinetit të Kryeministrit;
- f) drejtori i Protokollit të Kryeministrit;
- g) drejtori ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil;
- gj) drejtori i përgjithshëm i *Albcontrol*-it;
- h) drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar;
- i) drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
- j) drejtori i përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar;
- k) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile;
- l) drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim;
- ll) drejtori i përgjithshëm i Çështjeve Politike dhe Strategjike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- m) drejtori i Drejtorisë së NATO-s dhe Çështjeve të Sigurisë në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- n) përfaqësuesi i Bashkisë Tiranë.

7. Anëtarët e Skuadrës Kombëtare të Organizimit ushtrojnë përgjegjësinë e koordinatorëve kombëtarë sektorialë për fushat përkatëse.

8. Mbledhjet e Skuadrës Kombëtare të Organizimit thirren nga kryetari sa herë që vlerësohet e nevojshme.

9. Kryetari ka të drejtë të thërrasë mbledhje të natyrës teknike me pjesëmarrje më të kufizuar, në varësi të problematikave/çështjeve që do të diskutohen dhe të konfidencialitetit.

10. Në mbledhjet e Skuadrës Kombëtare të Organizimit mund të ftohen përfaqësues të institucioneve të tjera publike, enteve private dhe ekspertë vendas e të huaj, në varësi të problematikave që do të trajtohen.

11. Skuadra Kombëtare e Organizimit është përgjegjëse për bashkërendimin me Task-Forcën e Samitit të NATO-s në Bruksel, me Misionin e Përhershëm të Shqipërisë në NATO, si dhe me task-forcat e vendeve pritëse të samiteve paraardhëse.

12. Detyrat e Skuadrës Kombëtare të Organizimit përfshijnë vlerësimin dhe propozimin e masave sektoriale për:

- a) sigurinë e delegacioneve dhe të personaliteteve shtetërore;
- b) përcaktimin e vendeve të zhvillimit të Samitit, eventeve dhe aktiviteteve ndihmëse;
- c) akomodimin e delegacioneve dhe të trupave shoqëruese;
- ç) transportin ajror, rrugor e logjistikën;
- d) mbulimin mediatik dhe komunikimin publik;
- dh) aspektet teknike, digjitale dhe të sigurisë kibernetike;
- e) çdo detyrë tjetër specifike që lidhet me organizimin e Samitit me miratimin e *Host Nation Task Force*.

13. Koordinatorit Kombëtar mbështetet në detyrën e tij nga një shtab i përhershëm, i përbërë nga personel civil e ushtarak, që ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

14. Personeli civil dhe ushtarak vendoset në dispozicion me kohë të plotë nga institucionet shtetërore.

15. Ministria e Mbrojtjes, sipas nevojave të Koordinatorit Kombëtar, mund të punësojë specialistë dhe ekspertë në të gjitha fushat që lidhen me organizimin e zhvillimin e Samitit.

16. Shtabi i Përhershëm ushtron funksionet e tij në mjediset e përgatitura posaçërisht pranë Ministrisë së Mbrojtjes, garnizoni “Skënderbej”, Tiranë.

17. *Host Nation Task Force* paraqet periodikisht pranë Kryeministrit dhe Këshillit të Ministrave raporte për ecurinë e përgatitjeve, si dhe rekomandime për vendimmarrje ndërsektoriale e financiare.

18. Ngarkohen institucionet që janë pjesë e Task-Forcës – *Host Nation Task Force* (HNTF) dhe të Skuadrës Kombëtare të Organizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama